



QKRMT Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
KRCT The Kosovo Rehabilitation
Center for Torture Victims

OBLIGIMET E SHTETIT PËR TRAJTIMIN E KRYERËSVE ME ÇRREGULLIME MENDORE

QKRMT POLICY BRIEF

Mbështetur nga: **SIGRID RAUSING TRUST**

Qershor 2024

OBLIGIMET E SHTETIT PËR TRAJTIMIN E KRYERËSVE ME ÇRREGULLIME MENDORE

Mbështetur nga: SIGRID RAUSING TRUST

Qershor 2024

Publikimet:

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)
Qershor 2024

Autor:

Albert Avdiu – ekspert ligjor i angazhuar nga QKRMT

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe nuk pasqyron qëndrimet e SIGRID RAUSING TRUST.

2024 © Të drejtat autoriale i përkasin QKRMT-së.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është organizatë e pavarur, joqeveritare dhe jofitimprurëse. E themeluar në vitin 1999, QKRMT ka për mision ofrimin e trajtimit dhe shërbimeve të rehabilitimit për viktimat e torturës dhe të keqtrajtuarve gjatë luftës në Kosovë.

Po ashtu, QKRMT është e angazhuar në promovimin, respektimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut për të gjitha etnitetet në Kosovë, si dhe në parandalimin dhe çrrënjosjen e torturës dhe çdo forme tjetër të keqtrajtimit, përmes monitorimit të të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit në Kosovë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), këtë vit shënon 25 vjetorin e themelimit. Gjatë ekzistencës së saj, QKRMT ka mbi 17 vjet përvojë në monitorimin e vendeve të privimit nga liria, ku deri më tani ka realizuar mbi 250 vizita monitoruese dhe ka intervistuar mbi 4000 persona të privuar nga liria.



1 OBLIGIMET E SHTETIT PËR TRAJTIMIN E KRYERËSVE ME ÇRREGULLIME MENDORE

Përmbledhje ekzekutive

E drejta e qasjes në shërbime të shëndetit mendor për kryerësit me çrregullime mendore të akuzuar ose të dënuar për vepra penale, vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore me të cilën përballen institucionet e Republikës së Kosovës. Pavarësisht obligimeve ligjore të institucioneve shtetërore për sigurimin e trajtimit adekuat, por edhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe angazhimit të tyre gjatë viteve të fundit, një numër i konsiderueshëm i kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore ende përballen me sfida të mëdha sa i përket kujdesit të shëndetit mendor, duke rezultuar në pasoja të rënda për mirëqenien e tyre dhe trajtim jashtë standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut. Parimi i ekuivalencës është aspekti thelbësor i cili duhet patjetër të respektohet, pasi që i ndalon institucionet shtetërore që të ofrojnë shërbime shëndetësore më inferiore në vendet e privimit të lirisë në krahasim me ato të disponueshme në komunitet. Në mënyrë eksplicite ndalon çdo përkeqësim të shëndetit të individëve për shkak të kushteve të vështira dhe shërbimeve të papërshtatshme mjekësore brenda ambienteve të burgut.¹ Duke konsideruar natyrën fundamentale të së drejtës për shëndet pa asnjë formë diskriminimi, veçanërisht për personat e privuar nga liria, parimi i ekuivalencës i obligon institucionet shtetërore për të mbështetur dhe mbrojtur mirëqenien e individëve në sistemin e burgjeve.²

Si përgjigje ndaj sfidave të identifikuara, ky dokument politikash avokon për një ndryshim paradigme në trajtimin e kryerësve me çrregullime të shëndetit mendor në vendet e privimit nga liria, duke theksuar urgjencën e adresimit të sfidave sistematike. Tutje, identifikon mangësitë në trajtimin adekuat për kryerësit me probleme të shëndetit mendor në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës, shtjellon standardet ndërkombëtare dhe rëndësinë e tyre dhe obligimet ligjore të institucioneve shtetërore për ndërmarrjen e veprimeve konkrete. Mbi bazën e këtyre hulumtimeve, duke u nisur nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe domosdoshmëria për të ruajtur dinjitetin dhe sigurimin e mirëqenies për personat e privuar nga liria, dokumenti paraqet edhe rekomandimet përkatëse për institucionet shtetërore.

1 Trajtimi i personave me çrregullime mendore në institucionet korrektuese në Kosovë

Që nga viti 2007, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) i është përkushtuar avancimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit nga liria në mbarë Kosovën, si pjesë e mandatit të saj për të luftuar torturën. Mandati unik i QKRMT-së përqendrohet në luftimin e torturës përmes monitorimit, dokumentimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe propozimit të politikave reformuese për institucionet shtetërore. Aktiviteti parandalues realizohet përmes vizitave monitoruese të rregullta dhe tematike në institucionet e paraburgimit dhe korrektuese, me ekipe multidisiplinare të përbërë nga profesionistë mjekësorë, psikolog, punonjës socialë dhe juristë. Vizitat monitoruese të QKRMT-së fokusohen në trajtimin që ju bëhet të burgosurve brenda institucioneve korrektues, duke filluar nga kategorizimi dhe regjimet, shërbimet sociale e shëndetësore që ju ofrohen të burgosurve si dhe garancitë procedurale për adresimin shkeljeve eventuale.

¹ *Khudobin v. Ruisë*, Nr. i aplikimit 59696/00 (GjEDNj 26 tetor 2006) para. 93.

² Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) Neni 12; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965) Neni 5; Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006) Neni 25.

Në këtë drejtim, një problematik e observuar nga QKRMT-ja në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit të Kosovës është trajtimi jo-adekuat i kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore. Kjo gjetje e QKRMT-së është konstatuar edhe nga Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) si dhe nga Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), duke e vlerësuar si një nga sfidat e vazhdueshme në Shërbimin Korrektues.³

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), çrregullimet mendore përshijnë depresionin, çrregullimin bipolar, skizofrenin dhe psikoza të tjera, demenca dhe çrregullime zhvillimore, duke përfshirë autizmin.⁴ OBSH ka vënë në pah se vendosja e personit në një institucion të mbyllur ka shumë gjasa të ndikojë negativisht në shëndetin mendor, si rezultat i mbipopullimit, dhunës eventuale, vetmisë së detyruar, mungesës së privatësisë, aktiviteteve të pamjaftueshme, pasigurisë për të ardhmen dhe shërbimeve të pamjaftueshme të shëndetit mendor. Për adresimin e këtyre rrethanave, OBSH-ja rekomandon ndërmarrjen e masave për zbulimin, parandalimin dhe trajtimin efikas të çrregullimeve mendore brenda institucioneve korrektuese.⁵

Përgjatë vitit 2021, në institucionet korrektuese të Kosovës janë evidentuar nëntë vdekje, prej të cilave tri kanë qenë vetëvrasje. Të tri vetëvrasjet janë kryer nga persona me çrregullime mendore. Sipas vlerësimeve të QKRMT-së, këto vetëvrasje kanë ndodhur në tri institucione në të cilat nuk është dashur të vendosen kryerës me çrregullime mendore. Personat e vetëvrasurë kanë vuajtur nga probleme të rënda të shëndetit mendor, e institucionet ku kanë qenë të vendosur nuk kanë pasur kapacitete për të ofruar as kushtet minimale për trajtimin adekuat të personave me çrregullime mendore.⁶

Pas këtyre ngjarjeve, QKRMT alarmoj institucionet shtetërore për gjendjen e rënduar sa i përket trajtimit të personave me çrregullime mendore nëpër institucionet korrektuese. QKRMT ka avokuar me vite për nevojën e krijimit të ambienteve adekuate në aspektin infrastrukturor dhe të stafit profesional për vendosjen e kryerësve me çrregullime mendore të cilët bien ndesh me ligjin.

3 Raporti i Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT), (2021) faqe 38 <<https://rm.coe.int/1680a3ea32>>; Raporti vjetor i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës (2022) faqe 33 <<https://oik-rks.org/2023/04/24/raporti-vjetor-i-mkp-se-2022/>>.

4 Organizata Botërore e Shëndetësisë <<https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/mental-disorders>>.

5 Këshilli i Evropës *White Paper në lidhje me personat me çrregullime të shëndetit mendor* (2022) faqe 8-10 <<https://rm.coe.int/pc-cp-2021-8-rev-6-white-paper-regarding-persons-with-mental-health-di/1680a69439>>

6 QKRMT *Të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese në Kosovë* (2021) faqe 21, 24, 25 dhe 26.

2 SI VENDOSËT PËR INSTITUCIONIN KU DUHET TË MBAHEN KRYERËSIT E VEPRAVE PENALE ME ÇRREGULLIME MENDORE?

2.1 Korniza ligjore

Legjislacioni vendor primar është i hartuar në përputhje me standardet evropiane dhe konsiderohet të jetë mjaftë i avancuar, sidomos në aspektin e përcaktimit të të drejtave të njeriut dhe përcaktimit të përgjegjësiave të institucioneve shtetërore. Kjo kornizë ligjore përbëhet nga Ligji për Shëndetin Mendor, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

Ligji i Shëndetit Mendor, është ligji special për rregullimin ligjor të shëndetit mendor në Republikën e Kosovës. Edhe pse në fuqi qysh nga viti 2015, mbetet dokument i pazbatueshëm meqë asnjë nga aktet nënligjore për implementimin e tij ende nuk janë hartuar. Ky ligj përcakton obligimin për trajtimin e barabartë shëndetësor për individët me çrregullime mendore në institucione për vuajtje të dënimeve penale, sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Shërbimet e shëndetit mendor, të mbikëqyrura nga Ministria e Shëndetësisë, janë përgjegjëse për ofrimin e asistencës së nevojshme në diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e pacientëve brenda institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale.⁷

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP-i) është ligji i cili e rregullon ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, si dhe masën e paraburgimit.⁸ LESP-i mes tjerash i specifikon protokollat mjekësore dhe përgjegjësitë brenda institucioneve korrektuese për kryerësit me çrregullime mendore. Pas pranimit në institucion, çdo person duhet të ekzaminohet nga mjeku, për të vlerësuar shëndetin e tij fizik dhe mendor, duke e përcjell me ekzaminime të mëvonshme sipas nevojës. Nëse dyshohet për çrregullime mendore, institucioni obligohet të ndërmerr masa të menjëhershme në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregullat e kujdesit psikiatrik.⁹ Mjeku është i detyruar të njoftojë drejtorin e institucionit korrektues për çdo përkeqësim të shëndetit të personit të dënuar për shkak të kushteve të burgimit dhe të ndërmerren hapa për trajtimin sa më të mirë të sëmundjeve shëndetësore në bazë të standardeve të cilat aplikohen edhe në institucionet shëndetësore në komunitet.¹⁰

Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë aktet kryesore ligjore që përcaktojnë detyrimet e institucioneve shtetërore për gjykimin, dënimin dhe përcaktimin e institucionit për vuajtjen e dënimit ose masën për trajtim të detyrueshëm për kryerësit me çrregullime mendore.

Kodi Penal i njeh rastet kur personi i paaftë mendërisht ose me aftësi të zvogëluar mendore kryen veprë penale dhe kërkon që këto rrethana të merren parasysh nga gjykata gjatë vendosjes së sanksionit apo masës dhe kohëzgjatjes së tyre. Kodi Penal e rithekson obligimin që kryerësi me çrregullim mendor duhet të *trajtohet me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e qenësishëm të njeriut*.¹¹

⁷ Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor (2015) neni 28 <<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11229>>.

⁸ Ligji NR. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP 2022) <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61303>>.

⁹ Ibid neni 46.

¹⁰ Ibid 49.

¹¹ Kodi NR. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019) neni 18 dhe 83 <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>>.

Vendimmarrja se në cilin institucion duhet të vendoset një person me çrregullime mendore, i cili ka rënë ndesh me ligjin, i takon gjyqtarit kompetent. Sipas Kodit të Procedurës Penale, kur ka dyshime se personi ka çrregullime mendore, gjykatësi obligohet të kërkojë ekzaminim mjekësor specialistik. Nëse vërtetohet çrregullimi mendor, personit të tillë i cakton **mbajtjen e paraburgimit në një institucion të kujdesit shëndetësor**. Në rastin kur i është caktuar paraburgimi një personi për të cilin gjatë procedurës gjyqësore nuk janë ngritur indikacione se mund të ketë çrregullime mendore, por i njëjti vërehet në institucionin korrektues nga stafi mjekësor, menjëherë i kërkohet gjyqtari që të urdhërojë ekzaminim psikiatrik.¹² Përderisa kjo procedurë zbatohet pa vonesa, mund të konsiderohet se zbatimi i kërkesave ligjore për trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore është i duhur.

Në praktikë, janë edhe disa situata të tjera, në të cilat institucionet shtetërore nuk i ndjekin kërkesat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Nga monitorimet e realizuara të QKRMT-së, janë gjetur raste të shumta të vendosjes jo-adekuate të kryerësve me çrregullime mendore. Rastet më të shpeshta të identifikuara, janë:

- ✔ Në rastet kur ka përfunduar qëndrimi në IPFK, është konstatuar çrregullimi mendor dhe i është paraqitur kërkesa gjykatës për nxjerrjen e vendimit për dërgimin e personit për mbajtje të paraburgimit në një institucion të kujdesit shëndetësor apo për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, mirëpo deri në nxjerrjen e vendimit gjykata merr kohë më të gjatë ndërsa personi mbetet në ambiente të institucioneve korrektuese;
- ✔ Një numër i konsiderueshëm i të burgosurve, çrregullimet mendore i evidentojnë gjatë kohës sa vuajnë dënimin. Këto janë raste të gjykuara dhe përveç dërgimit për trajtim të përkohshëm në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor, pjesën tjetër të kohës janë të detyruar ta kalojnë në ambientet e institucioneve korrektuese;
- ✔ Në institucionet korrektuese mbahen edhe kategoria e personave të cilët kohë pas kohe shfaqin simptoma të çrregullimeve mendore, të cilët përveç shërbimeve të rregullta brenda institucioneve korrektuese, nuk kanë ndonjë tretman më të veçantë. Në raste të caktuara, persona nga kjo kategori vendosen në ambiente të njëjta me të burgosurit e tjerë të cilët nuk kanë probleme shëndetësore.
- ✔ Kur gjykata nxjerr vendim që paraburgimi të mbahet në IPFK, mirëpo për shkak se në IPFK nuk ka vende të lira, personi dërgohet për mbajtje të paraburgimit në ndonjë qendër paraburgimi. QKRMT e ka ngritur këtë shqetësim, duke ju kërkuar qendrave të paraburgimit që personat për të cilët gjykata ka urdhëruar që të dërgohen në IPFK, të mos pranohen pasi që bëjnë shkelje të kërkesave që implikon Kodi i Procedurës Penale.

¹² ibid neni 509.

2.2. Institucionet e specializuara të Kosovës për kryerësit me çrregullime mendore

Kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, kur ju caktohet masa e paraburgimit apo dënimi me burgim, bazuar në kornizën ligjore, si dhe në praktikën e monitoruar nga QKRMT-ja, vendosen në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK), si dhe në Institucionin Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IShTPNV) në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Vetëm IPFK-ja dhe IShTPNV-ja i plotësojnë kushtet infrastrukturore dhe profesionale për akomodimin dhe trajtimin e kësaj kategorie.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK)

IPFK është institucion i specializuar shëndetësor për ekzaminime, ekspertiza psikiatrike dhe trajtimin e kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, mbi bazën e urdhëresave të gjykatave. Në repartin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, i cili ka kapacitet prej 24 shtretërve, bëhet mjekimi i pacientëve psikiatrik me urdhër të Gjykatave për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim.

Në repartin e trajtimit dhe evaluimit psikiatrik, me kapacitet prej 12 shtretërve, bëhen ekzaminimet e personave sipas urdhëresave të gjykatës me qëllim të vlerësimit psikiatrik për personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për të cilët është shqiptuar masa e paraburgimit. Personat në këtë repart mund të qëndrojnë deri në dy javë, ndërsa qëndrimi i tyre mund të zgjatet edhe dy javë tjera sipas kërkesës së ekipit vlerësues.

Edhe pse është institucion i specializuar për trajtimin e kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore, IPFK nuk posedon kapacitete të mjaftueshme, meqenëse i ka vetëm 36 shtretër. Përveç mungesës së kapaciteteve, IPFK ende nuk e ka të rregulluar statusin ligjor. Ky institucion është themeluar duke u bazuar në Rregulloren 2004/34 të UNMIK-ut dhe megjithë zhvillimet ligjore në Republikën e Kosovës statusi i tij ende nuk është i rregulluar. Ky problem është identifikuar edhe nga KPT-ja, duke vlerësuar se mos-rregullimi i statusit ligjor të IPFK-së ndikon ndjeshëm funksionimin e duhur.

Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IShTPNV)

Gjatë vitit 2023 është bërë hapja e Pavionit D në QK Dubravë apo siç njihet tashmë Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IShTPNV). Sipas të dhënave publike, ky institucion përbëhet nga njësi të ndryshme, me kapacitet të përgjithshëm prej 60 vendeve, duke përfshirë. Njësia për trajtim të shtuar mental, Njësia për trajtimin e personave me sëmundje të varësisë dhe Njësia për trajtimin e sëmundjeve kronike.

Megjithë nismën për përshtatjen e Pavionit D, gjendja mbeti thuajse e njëjtë edhe gjatë vitit 2023. QKRMT gjatë vizitave monitoruese në vitin 2022 dhe 2023, në shumicën dërmuese të institucioneve korrektuese ka konstatuar se janë akomoduar të burgosur me çrregullime mendore.

Si rezultat i monitorimeve, QKRMT-ja ka ngritur si shqetësim edhe trajtimin e pacientëve me probleme mendore në Qendrën Korrektuese të Grave në Lipjan, ku gratë me çrregullime mendore mbahen së bashku me të paraburgosurat/të dënuarat tjera, kurse shërbimet shëndetësore në dispozicion për to nuk i plotësojnë kushtet adekuate. Përveç mundësisë për dërgim në IPFK, nuk ka ndonjë hapësirë adekuate për këtë kategori. Në repartin C të IPFK-së janë dy dhoma dyshe të destinuara për gra dhe të mitura, mirëpo në shumicën e rasteve përdoren për vendosjen e meshkujve, ndërsa në rastet kur vendosen gratë në këto dhoma, ato nuk mund t'i shfrytëzojnë hapësirat për aktivitete sepse të njëjtat nuk janë të ndara nga burrat.

Ambientet infrastrukturore në institucionet korrektuese nuk ofrojnë as kushtet minimale për vendosjen e personave me çrregullime mendore, ndërsa stafi korrektues nuk e ka përgatitjen e duhur profesionale për trajtimin e tyre. Shërbimet shëndetësore që mund të ofrohen nga stafi mjekësor nëpër institucionet korrektuese janë shumë të kufizuara, si në aspektin e programeve adekuate ashtu edhe në numrin e mjaftueshëm të stafit mjekësor. Këto situata, përveç që paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut, janë shumë vështirë të menaxhueshme për shkak të specifikave që kjo kategori e të burgosurve i ka dhe rrjedhimisht ka potencial për implikime edhe në aspektin e sigurisë të institucioneve.





3 STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E KRYERËSVE ME ÇRREGULLIME MENDORE

Në këtë pjesë shtjellohen standardet ndërkombëtare sa i përket trajtimit që duhet t'ju sigurohet kryerësve me çrregullime mendore dhe obligimet e shtetit ndaj kësaj kategorie. Disa nga këto kërkesa janë të natyrës së standardeve minimale që duhet të respektohen, ndërsa kërkesat që dalin nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Rregullat Evropiane të Burgjeve (EPR) paraqesin një kornizë gjithëpërfshirës të standardeve në lidhje me menaxhimin dhe trajtimin e personave brenda burgjeve. Rregulli 12 i EPR rekomandon që personat me çrregullime mendore duhet të mbahen në ambiente të specializuara të krijuara për këtë qëllim, ndërsa në rast se mbahen në institucione korrektuese thekson nevojën për kushte të përshtatshme që adresojnë nevojat e tyre specifike.¹³

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor (KPT), ka trajtuar vazhdimisht menaxhimin e individëve me çrregullime mendore në raportet e vizitave monitoruese, duke ofruar rekomandime specifike për të përmirësuar trajtimin e kësaj kategorie.

Sipas KPT-së, është imperative që të burgosurit me çrregullime mendore të kenë qasje të vazhdueshme në shërbime shëndetësore profesionale, duke i vendosur në institucione të specializuara.¹⁴ Sëmundjet mendore të patrajtuara profesionalisht nxisin marginalizim dhe mund të qojnë në trajtim të mundshëm çnjerëzor dhe degradues. Prandaj, KPT rekomandon vazhdimisht që institucionet shtetërore të sigurojnë një gamë të gjerë të masave, përfshirë krijimin e hapësirave adekuate, qasje të vazhdueshme në shërbime shëndetësore, furnizime të rregullta të terapive psikotrope, trajnimin e vazhdueshëm të personelit mjekësor për të diagnostikuar dhe menaxhuar çrregullimet e shëndetit mendor.¹⁵ KPT e konsideron shumë të rëndësishëm edhe trajnimin e të gjithë zyrtarëve korrektuese për shëndetin mendor, psikologjinë, parandalimin e vetëvrasjeve, bullizmit,

¹³ Rregullat Evropiane të Burgjeve <<https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>>.

¹⁴ Raporti i tretë i Përgjithshëm i KPT-së (1993) Pjesa 12 para. 43.

¹⁵ Raporti i KPT-së nga vizita në Turqi (2005) 18 para. 83

ndërgjegjësimin kulturor, etj, për të qenë në gjendje të ndërveprojnë dhe të ofrojnë mbështetje për të burgosurit me çrregullime mendore.¹⁶

Pas vizitës së fundit në Kosovë në vitin 2021, KPT kërkoj që të burgosurit me probleme mendore të rënda të vendosen në një mjedis të përshtatshëm terapeutik, të shoqëruar me një plan individual të trajtimit, ku ju sigurohen shërbime të vazhdueshme terapeutike, rehabilituese dhe aktivitete rekreative.¹⁷

GJEDNJ-ja, thekson se shtetet duhet të sigurojnë që kushtet e vendosjes për të burgosurit, veçanërisht ata me sëmundje mendore, të mos rezultojnë në vështirësi që tejkalojnë vuajtjen e qenësishme të burgimit.¹⁸ Sipas nenit 3 të Konventës, GJEDNJ-ja pohon se ***ndalimi i vazhdueshëm i një personi pa mbikëqyrjen dhe trajtimin e duhur mjekësor përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues***, veçanërisht për të burgosurit me çrregullime të rënda mendore dhe prirje vetëvrasëse.¹⁹ Cenueshmëria dhe aftësia për të komunikuar ankesat duhet të merren parasysh kur vlerësohet përputhshmëria e kushteve të paraburgimit me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore.²⁰ Sipas GjEDNJ-së, ***shteti është i detyruar të marrë masa efektive, përfshirë trajtimin e specializuar dhe kushte të përshtatshme të paraburgimit, për individët me çrregullime mendore dhe t'i transferojë ata në mjedise të përshtatshme*** nëse kjo është e nevojshme.²¹

GJEDNJ-ja gjithashtu e lidh ligjshmërinë e heqjes së lirisë së të burgosurve sipas nenit 5 me kushtet e trajtimit të tyre, duke theksuar rëndësinë e mjediseve të përshtatshme për personat me çrregullime mendore.²² Gjykata vlerëson *përshtatshmërinë* e trajtimit duke marrë parasysh mendimet e profesionistëve shëndetësorë, vendimet e autoriteteve shtetërore dhe gjetjet e përgjithshme në lidhje me ofrimin e kujdesit shëndetësor në burgje. GJEDNJ konsideron nëse një qasje e individualizuar dhe e specializuar është e qasshme për trajtimin e çrregullimeve specifike dhe e cila synon riintegrimin e individëve në shoqëri. Shkelje sipas nenit 3 janë konstatuar në rastet kur të burgosurit me sëmundje mendore iu nënshtruan sanksioneve disiplinore pa mbikëqyrjen dhe trajtimin e nevojshëm.²³

16 Raporti i KPT-së nga vizita në Mbretërinë e Bashkuar (2008) para. 75; Raporti i KPT-së nga vizita në Rumani (2022) 06 para, 67.

17 Raporti i Komitetit për Parandalimin e Torturës (n 3) faqe 38.

18 Kudla v. Polonisë Nr. i aplikimit 30210/96 (GjEDNJ 26 tetor 2000).

19 Rivière v. Francës Nr. i aplikimit 33834/03 (GjEDNJ 11 korrik 2006).

20 Rooman v. Belgjikës Nr. i aplikimit 18052/11 (GjEDNJ 31 janar 2019); Murray v. Holandës Nr. i aplikimit 10511/10 (GjEDNJ 26 prill 2016).

21 Murray v. Holandës Nr. i aplikimit 10511/10 (GjEDNJ 26 prill 2016).

22 Ilseher v. Gjermanisë Nr. i aplikimit 10211/12 27505/14 (GjEDNJ 4 dhjetor 2018).

23 Rooman v. Belgjikës Nr. i aplikimit 18052/11 (GjEDNJ 31 janar 2019).

4 REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET SHETËRORE PËR TRAJTIMIN SIPAS STANDARDEVE TË KRYERËSVE TË VEPRAVE PENALE ME ÇRREGULLIME MENDORE

Në dritën e elaborimeve të mësipërme, veprimet në vijim rekomandohet të konsiderohen si masa urgjente për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për adresimin e mangësive në sistemin e trajtimit të kryerësve me çrregullime mendore:

» Rritja urgjente e kapaciteteve të institucioneve të specializuara

Institucionet shtetërore duhet të zhvillojnë politika për zgjerimin e kapaciteteve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Përveç rritjes së kapaciteteve, duhet të bëhet dhe rregullimi ligjor i funksionimit të këtij instituti. Kjo vlerësohet si masë mëse e nevojshme me qëllim të mënjanimin të vonesave potencialisht kërcënuese për jetën e kryerësve me çrregullime të rëndë mendore në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit.²⁴

Sa i përket hapësirave akomoduese, institucionet shtetërore duhet ta trajtojnë me urgjencë krijimin e hapësirave adekuate për trajtimin e femrave me çrregullime mendore dhe femrave të mitura të cilat dyshohen për kryerje të veprave penale ose janë të dënuara.

» Të ndalohet vendosja në institucione korrektuese/qendra të paraburgimit e personave me çrregullime mendore

Gjykatat dhe institucionet tjera shtetërore, vendimmarrjen ta bazojnë në një qasje të përqendruar të drejtat e njeriut, duke harmonizuar politikat dhe praktikën me standardet ndërkombëtare për të mbrojtur dinjitetin dhe mirëqenien e individëve me probleme të shëndetit mendor në paraburgim. Duhet të ndalohet praktika e vendosjes në qendra të paraburgimit, mbi arsyetimin e mungesës së vendeve të lira në IPFK.

Institucionet përgjegjëse (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera relevante) urgjentisht duhet të ndërmarrin masa për krijimin e institucioneve të veçanta për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Po ashtu, rekomandohet të dizajnohen dhe të mbahen trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët, për ndërgjegjësimin e tyre për shkelësit me çrregullime mendore dhe rrezikun shëndetësor dhe ligjor të vendosjes së tyre në institucione pa mjedise adekuate të trajtimit dhe kujdesit shëndetësor.

E një rëndësie të veçantë është edhe trajnimi i stafit korrektues në lidhje me shëndetin mendor, psikologjinë, parandalimin e vetëvrasjeve, etj. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve për ofrimin e një trajtimi më adekuat për personat me çrregullime mendore nëpër institucionet e privimit nga liria.

²⁴ Projekti i Këshillit të Evropës: Përmirësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria Raporti i vlerësimit mbi dispozitat e kujdesit shëndetësor mendor në të gjitha vendet e paraburgimit dhe protokollet e shëndetit mendor të Departamentit të Shëndetit të Burgjeve në Kosovë, duke përfshirë dhe Procedurat Standarde Operative (dhjetor 2022) faqe 5.

» Qasje e vazhdueshme në shërbime profesionale shëndetësore

Në rastet kur kryerësit me çrregullime mendore, edhe pse në kundërshtim me kërkesat ligjore, por janë të vendosur në institucionet korrektuese, duhet tu sigurohet mbikëqyrje dhe kontrolle të vazhdueshme të profesionistëve shëndetësor. Në institucionet korrektuese, në masën më të madhe kryerësve me çrregullime mendore ju ofrohet trajtim farmakologjik, në mungesë të opsioneve tjera siç janë trajtimet psiko-sociale, terapi rehabilituese dhe okupacionale. Këto dhe programe tjera alternative është shumë e nevojshme të zhvillohen dhe të implementohen në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit.²⁵



²⁵ ibid faqe 6.

5 KONKLUZION

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës e njeh detyrimin e institucioneve shtetërore për t'ju ofruar kryerësve me çrregullime mendore trajtimin e duhur shëndetësor, veçanërisht shërbimet profesionale të shëndetit mendor, në nivel të njëjtë me shërbimet që janë të disponueshme për personat në liri. Gjithashtu, përmes standardeve të afirmuara, GJEDNJ-ja paraqet kërkesa specifike për institucionet shtetërore kur është në pyetje trajtimi i kryerësve me çrregullime mendore. Institucionet shtetërore, në çdo fazë obligohen të sigurojnë nivelin e përshtatshëm të trajtimit profesional për kryerësit me çrregullime mendore. GJEDNJ-ja ka vendosur standarde shumë të larta, aq sa ka konstatuar se kur një personi të privuar nga liria nuk i sigurohet mbikëqyrje dhe trajtim profesional mjekësor i vazhdueshëm, atëherë mund të konstatohet se shteti bën shkelje të nenit 3 të Konventës, duke gjetur trajtim çnjerëzor dhe degradues.²⁶ Tashmë kur Republika e Kosovës ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj si dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëuese do të jenë edhe më relevante. Gjatë procesit të vlerësimit për përmbushjen e standardeve të kërkuara, Këshilli i Evropës vëmendje të veçantë do t'i kushtoj reflektimit të këtyre Konventave dhe praktikës së GJEDNJ-së në legjislacionin vendor, e sidomos zbatimit në praktikë.

Mbi bazën e çështjeve të trajtuara në këtë dokument, mund të konstatohet se institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës nuk i zbatojnë në plotëni kërkesat ligjore për vlerësimin dhe vendosjen e kryerësve me çrregullime mendore, ekziston qasje e pamjaftueshme në shërbimet mendore në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, kryerësit me çrregullime mendore vendosen për periudha të gjata në institucionet korrektuese e në shumë raste në ambiente të njëjta me të burgosurit pa probleme shëndetësore, si dhe ka mungesë të theksuar të kapaciteteve në institucionet e specializuara shëndetësore për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Duke përafruar politikat me parimet e të drejtave të njeriut, zbatim të saktë të kërkesave ligjore së bashku me strategji gjithëpërfshirëse të kujdesit për shëndetin mendor për adresimin e nevojave unike të personave me çrregullime mendore, mund të nxitet një sistem korrektues më i drejtë dhe më njerëzor që respekton dinjitetin e qenësishëm të të gjithë individëve, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor dhe gjendja shëndetësore.

²⁶ Rivière v. Francës Nr. i aplikimit 33834/03 (GjEDNJ 11 korrik 2006).



QKRMT-KRCT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës

The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims

Publikimet 2024:

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve
të Torturës (QKRMT), Qershor 2024.

Kontakti:

QKRMT

Rr.Hamëz Jashari 16b/2

10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 243 707

E-mail: info@krct.org

Web-faqja: www.krct.org

